



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT OF KOSOVO		
QEVERIA E KOSOVËS Ministria e Shëndetësisë	GOVERNMENT OF KOSOVO Ministry of Health	VLADA KOSOVA Ministarstvo zdravstva

Udhëzim Administrativ (Shëndetësi) Nr. 05/2007

Ndalimi i pirjes së duhanit dhe vendosja e shenjave të ndalimit, shenjëzimi i paketimeve të prodhimeve të duhanit nga prodhuesit dhe importuesit e tij.

Ministria e Shëndetësisë,

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2001/9 “Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës”, Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, “Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë”, Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 “Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë”,

Bazuar në Ligjin Për Shëndetësi Nr. 2004/4, të shpallur me Rregulloren e UNMIK Nr 2004/31, dhe bazuar në Ligjin Për Duhanin Nr.02/L-36, neni 10, i shpallur me Rregulloren e UNMIK Nr. 2007/1,

Mbështetur në Politikën Shëndetësore të Kosovës, shkurt 2001,

Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të Shëndetësisë Kosovare 2005-2015,

E vendosur që të arrij standardet ndërkombëtare në sektorin e shëndetësisë,

nxjerr:

Udhëzimin Administrativ-Ndalimi i pirjes së duhanit dhe vendosja e shenjave të ndalimit, shenjëzimi i paketimeve të prodhimeve të duhanit nga prodhuesit dhe importuesit e tij.



Neni 1 Qëllimi

- 1.1. Me këtë udhëzim administrativ rregullohet ndalimi i pirjes së duhanit në vendet publike dhe vendosja e shenjave të ndalimit të pirjes së duhanit.
- 1.2. Vendosja e shenjzimeve në paketimet e prodhimeve të duhanit nga prodhuesit dhe importuesit e tij.

Neni 2 Përkufizimet

Të gjitha përkufizimet e cekura në nenin 2 të Ligjit për Duhanin kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë udhëzim administrativ.

Neni 3 Ndalimi i pirjes së duhanit në vendet publike

- 3.1. Pirja e duhanit është e ndaluar në të gjitha vendet publike.
- 3.2. Pirja e duhanit si përjashtim lejohet vetëm në vendet e caktuara për pirjen e tij.
- 3.3. Vendet e veçanta ku lejohet pirja e duhanit, përveç se duhet të jenë të kompletuara me pajisjet e nevojshme sipas Ligjit për Duhanin, nuk duhet të jenë më të mëdha se 30% e hapësirës së tërësishme të lokalit.
- 3.4. Organi përgjegjës i hapësirës publike mund të ndaloj tërësisht pirjen e duhanit brenda hapësirës së caktuar.

Neni 4 Vendosja e shenjave për ndalimin, respektivisht lejimin e pirjes së duhanit

- 4.1. Hapësirat publike duhet të jenë të pajisura me shenjat për ndalimin e pirjes së duhanit.
- 4.2. Në hapësirat publike ku pirja e duhanit është tërësisht e ndaluar duhet të vendosen shenjat në hyrje të objektit në fjalë si dhe brenda tij në vendet e dukshme. Shenjat duhet vendosur në pozita të tilla të cilat do të dukeshin nga largësia prej 5 m.
- 4.3. Në vendet e veçanta ku lejohet pirja e duhanit, duhet vendosur shenja që tregojnë lejimin e tij.

Neni 5 Vendosja e shenjzimeve në paketimet e prodhimeve të duhanit nga prodhuesit dhe importuesit e tij



Çdo lloj paketimi i duhanit dhe prodhimeve të tij, qoftë nga prodhuesi apo importuesi i tij, duhet të ketë shenjëzimet e parapara me nenin 6 të Ligjit për Duhanin.

Neni 6 Mbikëqyrja

Mbikëqyrja e zbatimit të këtij udhëzimi administrativ bëhet në pajtim me dispozitat e parapara në Ligjin për Duhanin .

Neni 7 Sanksionet Administrative

Me qëllim të zbatimit të këtij udhëzimi administrativ, vlejné sanksionet administrative të parapara me dispozitat e Ligjit për Duhanin .

Neni 8 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Prishtinë
01 Tetor 2007



Sadik Idrizi
Sadik Idrizi
Ministër i Shëndetësisë

